



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE
RAPORTIMIT FINANCIAR
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 3182 Prot.

Tiranë, më 19 / 2 2026

URDHËR

Nr. 46, datë 19 / 2 2026

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E CERTIFIKIMIT TË
AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 19, të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” të ndryshuar,

URDHËROJ:

- 1 Miratimin e rregullores për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, hartuar nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, bashkëlidhur këtij urdhri.
- 2 Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm dhe Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Petrit Malaj



RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E CERTIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË
SEKTORIN PUBLIK

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i Rregullores

Rregullorja për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik (në vijim “Rregullorja”), ka për qëllim përcaktimin e kuadrit rregullues për organizimin, zhvillimin, administrimin dhe dokumentimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik. Rregullorja përcakton procedurat që ndiqen për programimin, organizimin dhe administrimin e procesit të certifikimit të kandidatëve për fitimin e titullit “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, si dhe procedurat për lëshimin e certifikatës përkatëse.

Neni 2
Baza ligjore.

Kjo Rregullore mbështetet në këto akte ligjore dhe nënligjore :

- a) Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;
- b) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 116, datë 17.02.2016, “Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”, i ndryshuar.
- c) “Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm”, miratuar me Urdhër nr.103, datë 23.07.2025 të Ministrit përgjegjës për financat.
- ç) “Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, miratuar me Urdhër nr.134, datë 17.10.2025 të Ministrit përgjegjës për financat.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Kandidat për auditues të brendshëm”**, (në vijim kandidati) është çdo individ që plotëson kriteret ligjore për certifikim dhe aplikon për ndjekjen e programit të certifikimit për fitimin e titullit “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

2. **“Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm”** (në vijim “Komisioni”), është organi kolegjial përgjegjës për mbikëqyrjen, garantimin e transparencës dhe vendimmarrjen në procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik.
3. **“Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm”** është struktura organizative në ministrinë përgjegjëse për financat e ngarkuar me administrimin dhe koordinimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik.
4. **“Trajner”** është individ i përzgjedhur dhe i miratuar nga Komisioni për zhvillimin e trajnimeve në kuadër të procesit të certifikimit, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse dhe në këtë Rregullore.
5. **“Modul certifikimi”** është një pjesë (njësi) tematike e programit të certifikimit, e cila përfundon me provim me shkrim.
6. **“Provimi Moduli”** është provimi i zhvilluar me shkrim në përfundim të çdo moduli të programit të miratuar të certifikimit, me qëllim vlerësimin e njohurive dhe aftësive të kandidatëve.
7. **“Certifikatë “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”** është dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministri përgjegjës për financat që vërteton përfundimin me sukses të procesit të certifikimit.

Neni 4
Subjektet e Rregullores

Subjekte të kësaj Rregulloreje janë:

- a) Ministri përgjegjës për financat;
- b) Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik;
- c) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm,
- ç) Trajnerët, mbikëqyrësit e provimeve dhe çdo punonjës tjetër i angazhuar në procesin e certifikimit, sipas përcaktimeve në këtë Rregullore.
- d) Kandidatët për auditues të brendshëm që marrin pjesë në procesin e certifikimit.

Neni 5
Organizimi i procesit të certifikimit

Procesi i certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik organizohet dhe administrohet nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm dhe struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, secila brenda kompetencave të përcaktuara në aktet nënligjore dhe në këtë Rregullore. Procesi i certifikimit përfshin fazat si vijon:

- a) Shpalljen e hapjes së sezonit të certifikimit;
- b) Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve;
- c) Hartimin dhe miratimin e programit të certifikimit;
- ç) Miratimin e kalendarit të zhvillimit të procesit të certifikimit;
- d) Procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe miratimit të trajnerëve;
- dh) Zhvillimin dhe administrimin e provimit për çdo modul;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

- e) Shpalljen e rezultateve të provimeve të moduleve, ndjekjen e procedurave të ankimit dhe shpalljen e rezultateve përfundimtare;
- ë) Lëshimin e certifikatës për kandidatët që kanë plotësuar kërkesat e detyrueshme për certifikim të përcaktuara në programin e miratuar të certifikimit;
- f) Regjistrimin e audituesve të certifikuar në Rregjistrin Kombëtar të Audituesve të Brendshëm.

KAPITULLI II

STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR CERTIFIKIMIN E AUDITUESVE TË BRENDSHËM

Neni 6

Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm

Komisioni është organi kolegjal përgjegjës për mbikëqyrjen dhe garantimin e zbatimit të parimeve të transparencës, të barazisë dhe paanësisë së procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, në përputhje me këtë Rregullore. Komisioni kryen këto funksione:

- 1) Mbikëqyr procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik;
- 2) Për çdo sezon certifikimi, shqyrton dhe miraton Programin e Certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, si edhe Kalendarin e zhvillimit të Procesit të Certifikimit të propozuara nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat;
- 3) Përzgjedh dhe miraton trajnerët që do të angazhohen në procesin e certifikimit, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Rregullore;
- 4) Harton dhe miraton tezat e provimeve për çdo modul provimi të programi, si dhe të riprovimit, bazuar në fondin e pyetjeve të dorëzuara nga trajnerët e kategorisë së dytë.
- 5) Miraton fondin e pyetjeve, i cili depozitohet nga trajnerët një ditë pune përpara zhvillimit të provimit sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore;
- 6) Cakton trajnerët korrigjues për vlerësimin e provimeve dhe riprovimit të zhvilluara sipas përcaktimeve në pikën 4 të këtij neni;
- 7) Shqyrton ankesat e paraqitura nga kandidatët dhe merr vendime përkatëse në lidhje me procedurat e ndjekura për zhvillimin e procesit të certifikimit, si edhe me rezultatet e provimeve të zhvilluara nga kandidatët për auditues të brendshëm në sektorin publik;
- 8) Shqyrton dhe vendos për njohjen e certifikatave profesionale ndërkombëtare në fushën e auditimit të brendshëm, të lëshuara nga institucione të tjera, kombëtare dhe ndërkombëtare të njohura ligjërisht.
- 9) Informon ministrin përgjegjës për financat për ecurinë e procesit të certifikimit, nëpërmjet:
 - a. Raportit përmbledhës për çdo sezon certifikimi;
 - b. Raporteve të tjera, brenda fushës së veprimit të Komisionit, sa herë që kërkohen nga ministri.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

Sekretari i Komisionit:

Sekretari i Komisionit të Kualifikimit të audituesve të brendshëm caktohet nga Drejtori i Përgjithshëm i strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm (përzgjidhet ndër punonjësit e kësaj strukture) dhe është përgjegjës për:

- 1) Njoftimin e veprimtarive, përgatitjen e axhendës paraprake dhe materialeve të nevojshme për mbledhjet e Komisionit jo më vonë se 5 ditë para organizimit të mbledhjes, me kërkesë të Kryetarit të Komisionit si dhe në raste të tjera që përcaktohen në kuadrin ligjor në fuqi;
- 2) Mbajtjen e procesverbaleve, pasqyrimin e përfundimeve në vendimet përkatëse, administrimin dhe depozitimin e dokumentacionit përkatës në protokollin e ministrisë përgjegjëse për financat;
- 3) Arkivimin e dokumentacionit të Komisionit për çdo sezon certifikimi, në përfundim të procesit përkatës.

Neni 7

Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm

Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, është organi administrativ në ministrinë përgjegjëse për financat, përgjegjës për hartimin, zhvillimin dhe administrimin e politikave kombëtare për certifikimin e audituesve të brendshëm, në përputhje me praktikat bashkëkohore në fushën e auditimit të brendshëm. Në procesin e certifikimit, kjo strukturë ushtron këto funksione:

1. Kryen analizën e nevojave për certifikim të punonjësve të punësuar në njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe i paraqet ato për informacion dhe vendimmarrje tek Komisioni dhe ministri përgjegjës për financat.
2. Përgatit dhe dërgon për miratim tek ministri përgjegjës për financat urdhrin për fillimin e procesit të certifikimit, pas dakordësimit paraprak me Komisionin.
3. Njofton të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe publikon në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat, Urdhrin për fillimin e procesit të certifikimit.
4. Publikon në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat njoftimin për aplikimin për trajnerë në procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik.
5. Përgatit dhe propozon Programin dhe Kalendarin e procesit të certifikimit, si dhe i paraqet për miratim te Komisioni kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik.
6. Administron dokumentacionin e kandidatëve të regjistruar dhe pas miratimit nga Komisioni, publikon në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat, listat paraprake të kandidatëve të kualifikuar fitues për ndjekjen e Procesit të Certifikimit të audituesve të brendshëm.
7. Administron dokumentacionin e kandidatëve për trajner dhe e paraqet pranë Komisionit dokumentacionin shoqëruar me evidencën përmbledhëse, për vendimmarrje lidhur me përzgjedhjen e trajnerëve, që do të marrin pjesë në procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik.
8. Publikon në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat, listën e kandidatëve të kualifikuar për të ndjekur procesin e certifikimit, si dhe listën e trajnerëve të përzgjedhur.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

9. Përgatit listat e rezultateve të provimeve të çdo moduli, dhe riprovimit, të cilat ia paraqet Komisionit për miratim dhe njofton kandidatët për rezultatet e provimeve.
10. Siguron komunikim të vazhdueshëm me Komisionin mbi zbatimin e programit dhe ecurinë e procesit të certifikimit.
11. Publikon në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat rezultatet e provimeve për çdo modul dhe të riprovimit, si dhe listën përfundimtare të kandidatëve fitues të titullit “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, mbështetur në vendimmarrjen e Komisionit.
12. Shpërndan certifikatën “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, për të gjithë kandidatët që përfundojnë me sukses procesin e certifikimit, bazuar në vendimet e Komisionit duke e dokumentuar procesin në një regjistër shpërndarje.
13. Pas çdo procesi trajnimi organizon vlerësimin e performancës së trajnerëve nëpërmjet hartimit dhe përpunimit të formularëve të “Vlerësimit të performancës së certifikimit” dhe paraqitjen e raportit përkatës pranë Komisionit.
14. Administron, përditëson dhe publikon Regjistrin Kombëtar të Audituesve të Brendshëm të Certifikuar në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat.

Neni 8

Nëpunësi përgjegjës për procesin e certifikimit të audituesve të brendshëm

Nëpunësi i caktuar nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm për organizimin dhe administrimin e procesit të certifikimit është përgjegjës për:

- 1) Përpunimin dhe administrimin e të dhënave të kandidatëve që aplikojnë për t’u certifikuar si auditues të brendshëm, sipas afateve të përcaktuara dhe paraqitjen e listës së kandidatëve për miratim tek Komisioni;
- 2) Përpunimin dhe administrimin e të dhënave të kandidatëve për trajner që aplikojnë për përfshirje në procesin e certifikimit, në përputhje me afatet përkatëse, dhe paraqitjen e listës së kandidatëve për miratim tek Komisioni;
- 3) Përgatitjen e draftit të dokumenteve të lidhura me kalendarin e zhvillimit të procesit të certifikimit, ndarjen e grupeve, oraret dhe vendin ku do të zhvillohet aktiviteti për të cilat pasi ka marrë miratimin nga Komisioni, komunikon informacionin duke njoftuar çdo kandidat;
- 4) Administrimin, e moduleve, prezantimeve, rasteve studimore dhe materialeve të tjera të nevojshme për procesin e certifikimit, si dhe shpërndarjen e tyre tek kandidatët pjesëmarrës në proces, sipas kërkesave të kësaj Rregulloreje;
- 5) Mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me kandidatët dhe trajnerët e përzgjedhur;
- 6) Administrimin dhe evidentimin e listëprezencës për pjesëmarrjen e kandidatëve gjatë kohës së ndjekjes së procesit të certifikimit.
- 7) Mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës materiale dhe mjediseve ku zhvillohet procesi, duke siguruar zbatimin e programit sipas kalendarit.
- 8) Përgatitjen dhe ndjekjen e zbatimit të kontratave të lidhura midis palëve të përfshira në proces, me qëllim ndjekjen e detyrimeve dhe pagesave përkatëse për shërbimet e kryera nga trajnerët, dhe mbikëqyrësit e provimeve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

- 9) Ndjekjen e detyrimeve të palëve të treta për pagesat e tarifave të regjistrimit dhe çdo pagese tjetër të lidhur me ndjekjen e Programit të Certifikimit, kryerjen e rekordimit me strukturën përkatëse në ministrinë përgjegjëse për financat , me qëllim arkëtimin në kohë të tarifave dhe çdo lloj detyrimi financiar që lind nga zbatimi i Programit të Certifikimit.
- 10) Administron Ankesat e kandidatëve të lidhura me procesin e certifikimit, dhe i paraqet tek Sekretari i Komisionit.
- 11) Në bashkëpunim me Sekretarin e Komisionit, dorëzon në përfundim të procesit të certifikimit të gjithë dokumentacionin përkatës në arkivën e ministrisë përgjegjëse për financat, në përputhje me legjislacionin në fuqi

KAPITULLI III
PROCESI I CERTIFIKIMIT

Neni 9

Kriteret dhe procedura e regjistrimit të kandidatëve

Pas shpalljes dhe publikimit të urdhrit të ministrit përgjegjës për financat për fillimin e procesit të certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm organizon dhe administron procesin e regjistrimit të kandidatëve për certifikim.

- 1) Të drejtën për të aplikuar në procesin e certifikimit e kanë punonjësit që plotësojnë kriteret e përcaktuara në legjislacionin për auditimin e brendshëm në sektorin publik, si më poshtë.
 - a. Të kenë diplomë të arsimit të lartë të ciklit të dytë në shkencat ekonomike, juridike ose disiplina të tjera të përshtatshme me fushën e auditimit;
 - b. Të jenë të punësuar në njësitë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, për rastet e punësimit të audituesve të brendshëm të pa certifikuar, si dhe nëpunës civilë ose punonjës që kanë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion ose kryejnë detyra publike/akademike në fushat; auditimi i brendshëm, sigurimi i cilësisë, menaxhimi i riskut, inspektimi, përputhshmëri, auditimi i jashtëm, kontrolli i brendshëm ose fusha të ngjashme.
- 2) Kandidatët që aplikojnë për t'u certifikuar si auditues të brendshëm paraqesin zyrtarisht dokumentacionin e mëposhtëm pranë strukturës përgjegjëse:
 - a. Kërkesë me shkrim;
 - b. Curriculum Vitae;
 - c. Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave;
 - ç. Fotokopje të noterizuar të librezës së punës;
 - d. Vërtetim punësimi ku specifikohet edhe pozicioni në njësinë e auditimit të brendshëm (kur aplikanti është pjesë e saj) dhe në rastet kur janë nëpunës civilë ose punonjës që nuk janë pjesë e strukturës së auditimit të brendshëm, të specifikohet arsyeja e lëshimit të Vërtetimit;
 - dh. Certifikatën e gjendjes gjyqësore (informacion për rekordin penal), të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria dhe/ose në gjykim për vepra penale;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

e.Vërtetim nga puna që nuk janë marrë masa disiplinore ndaj tij.

- 3) Afatet, format e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të dokumentacionit përcaktohen në urdhrin për fillimin e procesit të certifikimit.
- 4) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm përgatit dhe shqyrton të dhënat e kandidatëve brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga përfundimi i afatit të aplikimit dhe i përcjell për miratim Komisionit listën e kandidatëve .
- 5) Komisioni miraton listën paraprake të kandidatëve të kualifikuar brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e saj.
- 6) Kandidatët kanë të drejtë ankimi brenda 5 (pesë) ditëve pune nga publikimi i listës paraprake. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm administron ankesat dhe ia përcjell Komisionit, i cili merr vendimin përfundimtar.
- 7) Pas miratimit nga Komisioni, struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm publikon menjëherë në faqen zyrtare të ministrisë listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar për ndjekjen e programit të certifikimit.

Neni 10

Kategoritë dhe kriteret për kandidatët për trajnerë

- 1) Trajnerët që angazhohen në procesin e certifikimit ndahen në dy kategori:
 - a) Trajner i kategorisë së parë;
 - b) Trajner i kategorisë së dytë.
 - 2) Komisioni, mbështetur në Programin e Certifikimit të miratuar, përcakton numrin e nevojshëm të trajnerëve dhe i përzgjedh ata në përputhje me kriteret e kësaj rregulloreje.
 - 3) Trajner i kategorisë së parë është kandidati që plotëson njërin nga kriteret e mëposhtme:
 - a) Diplomë Master i Shkencave/Master i Arteve, ose diplomë e barasvlershme me to dhe 6 (gjashtë) deri në 10 (dhjetë) vite përvojë profesionale në fushën e auditimit të brendshëm, kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut ose fusha të lidhura me to; ose
 - b) Diplomë post-master, ose e barasvlershme me të dhe jo më pak se 5 (pesë) vite përvojë profesionale në fushën përkatëse.
 - 4) Trajner i kategorisë së dytë, është kandidati që plotëson njërin nga kriteret e mëposhtme:
 - 1) Diplomë Master i Shkencave/Master i Arteve, ose diplomë e barasvlershme me to dhe më shumë se 10 (dhjetë) vite përvojë profesionale pune në fushën përkatëse; ose
 - 2) Gradë shkencore ose titull akademik dhe jo më pak se 7 (shtatë) vite përvojë profesionale pune në fushën përkatëse.
- Trajnerët e kategorisë së dytë angazhohen për:
- a) Zhvillimin e moduleeve me përmbajtje dhe tematikë të avancuar, bazuar në programin e certifikimit të miratuar;
 - b) Trajtimin dhe analizimin e rasteve studimore komplekse;
 - c) Ofrimin e mbështetjes metodologjike dhe pedagogjike për trajnerët e kategorisë së parë;
 - d) Përgatitjen dhe dorëzimin e fondit të pyetjeve për provimet e moduleve përkatëse, i cili shërben si bazë për hartimin dhe miratimin e tezave të provimit nga Komisioni i

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, në përputhje me strukturën e provimit të përcaktuar në këtë rregullore.

- 5) Përveç kriterëve të mësipërme, të gjithë kandidatët për trajnerë duhet të plotësojnë edhe kërkesat e përgjithshme profesionale dhe pedagogjike si vijon:
 - i. Njohuri të standardeve profesionale të auditimit të brendshëm dhe përvojë praktike në auditimin e brendshëm në sektorin publik;
 - ii. Aftësi për përgatitjen e programeve mësimore dhe për prezantimin e tyre;
 - iii. Aftësi për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe komenteve të pjesëmarrësve duke përdorur shembuj praktikë;
 - iv. Aftësi për zgjidhjen pragmatike të rasteve studimore;
 - v. Përkushtim për mbështetje për përvetësimin e njohurive nga kandidatët gjatë gjithë procesit të certifikimit;
 - vi. Aftësi të shkëlqyera prezantimi dhe komunikimi.
- 6) Çdo kandidat duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Kërkesë me shkrim;
 - b. Curriculum Vitae;
 - c. Dokument që vërteton përvojën profesionale në auditimin e brendshëm ose në fushën e trajnimit;
 - d. Fotokopje të noterizuara të diplomave;
 - e. Dy Letër Rekomandime dhe/ose certifikata që provojnë eksperiencën në trajnime profesionale, aftësitë pedagogjike.
 - f. Certifikatë të gjendjes gjyqësore.
 - g. Vërtetim që nuk janë marrë masa disiplinore ndaj tij.
 - h. Vërtetim që nuk është në ndjekje penale/(dokument nga Prokuroria).
- 7) Anëtarët e Komisionit nuk kanë të drejtë të jenë trajnerë në procesin e certifikimit.
- 8) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm përgatitë brenda 5 (pesë) ditëve pune evidencën e kandidatëve për trajner dhe i përcjell ato për shqyrtim dhe miratim tek Komisioni.

Neni 11
Procedura e përzgjedhjes së trajnerëve

- 1) Komisioni vlerëson kandidatët për trajner, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore dhe procesit të intervistimit, bazuar në metodologjinë e vlerësimit të miratuar. Metodologjia e vlerësimit bazohet në modelin e pikëzimit të ponderuar të kriterëve, sipas të cilit çdo kriteri i vendoset pesha dhe pikëzimi përkatës.
- 2) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, organizon kushtet për procesin e intervistimit.
- 3) Komisioni plotëson formularin e vlerësimit për secilin kandidat për trajner.
- 4) Në listën për përzgjedhjen përfundimtare, përfshihen kandidatët që kanë marrë një rezultat minimal të përgjithshëm prej 80 (tetëdhjetë) pikësh. Rezultati dokumentohet në formatin e vlerësimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

- 5) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, mbi bazën e vlerësimeve të Komisionit, përgatit informacionin dhe Listën Përfundimtare të kandidatëve të përzgjedhur për trajnerë.
- 6) Në përfundim të këtij procesi vlerësimi, në rast se nuk plotësohet numri i trajnerëve të përzgjedhur, rihapet procedura për zgjedhjen e kandidatëve të tjerë.
 - 6/1. Në rast se trajneri i zgjedhur tërhiqet nga procesi i zhvillimit të trajnimit, Komisioni miraton trajnerin tjetër zëvendësues, i cili është renditur i pari në listën konkurruese pas shpalljes së kandidatëve fitues, dhe kështu me radhë.
 - 6/2. Në rast se nga lista e kandidatëve për trajnerë të shpallur fitues nuk ka më kandidatë të renditur më pas, Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm kërkon zhvillimin e procedurës së përzgjedhjes së trajnerit të ri brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga marrja dijeni për dorëheqjen.
- 7) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, informon ministrin përgjegjës për financat për rezultatet e procesit të përzgjedhjes të trajnerëve, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e vendimit të Komisionit për miratimin e listës së trajnerëve.
- 8) Në përfundim të procesit të përzgjedhjes së trajnerëve, struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm propozon te Nëpunësi i Parë Autorizues projekt-kontratën midis trajnerit dhe ministrisë përgjegjëse për financat. Kontrata përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve, numrin e orëve mësimore, pagesën, detyrimin e trajnerit për dorëzimin e leksioneve në afatin e përcaktuar, dorëzimin e fondit të pyetjeve për tezat, etj.

Neni 12
Detyrat dhe përgjegjësitë e trajnerit

- 1) Trajneri është personi i përzgjedhur nga Komisioni përgjegjës, i cili ka për detyrë të zhvillojë procesin e trajnimit për certifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik në përputhje me Programin e Certifikimit të miratuar.
- 2) Trajneri është përgjegjës për:
 - a) Përgatitjen e planit të trajnimit në përputhje me programin e miratuar;
 - b) Përditësimin e materialeve mësimore bazuar në praktikën më të mira profesionale;
 - c) Përgatitjen dhe dorëzimin e fondit të pyetjeve për çdo modul provimi (vetëm trajnerët e kategorisë së dytë), i cili shërben si bazë për hartimin dhe miratimin e tezave të provimit nga Komisioni;
 - d) Të vepruar në përputhje me kodin etik të administratës publike dhe parimet e etikës profesionale të auditimit të brendshëm;
 - e) Të garantuar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave të kandidatëve dhe materialeve të përdorura.
- 3) Trajneri gjatë gjithë procesit nuk duhet të ketë konflikt interesi, si në fakt dhe në dukje, dhe mban standarde të larta të profesionalizmit dhe paanshmërisë.
- 4) Trajneri ka përgjegjësinë të dokumentojë dhe raportojë punën, duke ndjekur rregullat e mëposhtme:
 - a. Mban evidenca të rregullta mbi pjesëmarrjen dhe i dorëzon ato tek struktura

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.

- b. Evidenton çdo problematikë apo rekomandim që mund të kontribuojë në përmirësimin e programit të certifikimit.

Neni 13
Programi i Certifikimit

- 1) Programi i Certifikimit për Audituesit e Brendshëm në sektorin publik është dokumenti zyrtar i formimit profesional, i cili përcakton strukturën, përmbajtjen, metodologjinë dhe mënyrën e zhvillimit të procesit të certifikimit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.
- 2) Programi i Certifikimit miratohet nga Komisioni dhe rishikohet periodikisht, bazuar në rekomandimet e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm dhe zhvillimet profesionale në fushën e auditimit të brendshëm.
- 3) Programi i Certifikimit përbëhet nga pesë modulet bazë të detyrueshme, të cilat mbulojnë kompetencat thelbësore të profesionit të audituesit të brendshëm, duke përfshirë edhe fushat e kontrollit të brendshëm, qeverisjes, menaxhimit të riskut, planifikimit, kryerjes së auditimit, raportimit dhe sigurimit të cilësisë dhe komunikimin.
- 4) Trajnimi është i detyrueshëm dhe zhvillohet në klasë dhe/ose në mënyrë virtuale. Secili modul përfshin 3 (tre) seanca trajnimi, të mbështetura me ushtrime praktike, diskutime të drejtuara dhe materiale shtesë bazuar në programin e certifikimit të miratuar që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive praktike të kandidatëve.
- 5) Programi zbatohet edhe mbi parimin e vetëstudimit ku kandidatët kanë detyrimin të përvetësojnë materialet bazë të miratuara. Kohëzgjatja e rekomanduar e vetëstudimit për çdo modul propozohet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm dhe miratohet nga Komisioni.
- 6) Kohëzgjatja e një ore trajnimi është 60 (gjashtëdhjetë) minutash, pavarësisht formatit të zhvillimit (fizik ose virtual).
- 7) Në raste të paparashikuara, Komisioni mund të vendosë rishikimin e mënyrës së zhvillimit të trajnimeve, metodologjisë së vetëstudimit dhe kalendarit të provimeve.
- 8) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm organizon, koordinon dhe monitoron zbatimin e Programit të Certifikimit, siguron mjediset, infrastrukturën teknike dhe të gjitha materialet e nevojshme për realizimin e trajnimeve.

Neni 14
Modulet e Programit të Certifikimit

- 1) Programi i Certifikimit për Auditues të Brendshëm në Sektorin Publik përbëhet nga pesë module bazë:
 - a) **Moduli I- “Profesioni i Auditimit të Brendshëm”**: njohuri mbi kuadrin kombëtar dhe ndërkombëtar, standardet globale, përkufizimin dhe rolin e auditimit të brendshëm, dallimet midis auditimit të sigurisë dhe shërbimit të këshillimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

- b) **Moduli II- “Kontrolli i Brendshëm dhe Auditimi, Qeverisja, Menaxhimi i Riskut dhe Kontrollit”**: njohuri mbi kuadrin e kontrollit të brendshëm, qeverisjen, menaxhimin e riskut, kornizën evropiane të kontrollit financiar publik, auditimin e brendshëm, auditimin e jashtëm dhe inspektimin financiar.
 - c) **Moduli III- “Planifikimi i Auditimit të Brendshëm”**: vlerësimi i riskut, planifikimi strategjik dhe vjetor, zhvillimi i universit të auditimit, menaxhimi i burimeve dhe trajnimi i tyre.
 - d) **Moduli IV- “Kryerja e Auditimit të Brendshëm”**: planifikimi individual, teknikat e prezantimit, zbatimi i procedurave analitike, identifikimi i risqeve, hartimi i objektivave, programi i auditimit, testimet e kontrolleve, ndërtimi i evidencave dhe dokumentimi i punës audituese.
 - e) **Moduli V- “Raportimi dhe Sigurimi i Cilësisë”**: takimi i mbylljes me palën e audituar, projekt raporti dhe raport përfundimtar, rekomandimet dhe plani i veprimit, ndjekja e rekomandimeve, raporti vjetor dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë.
- 2) Çdo modul përfundon me provimin me shkrim. Kualifikimi në të gjithë provimet e moduleve është kusht i detyrueshëm për t’u certifikuar.

Neni 15

Kërkesat e procesit të certifikimit

- 1) Pas përfundimit të procedurës së regjistrimit të kandidatëve të shpallur fitues për ndjekjen e procesit të certifikimit, struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm ka detyrimin të organizojë grupet e studimit dhe të hartojë kalendarin përkatës të trajnimeve për secilin grup dhe pasi merr miratimin nga Komisioni merr masat e nevojshme për shpalljen e njoftimit në faqen zyrtare të ministrisë si dhe merr masat e nevojshme për njoftimin e kandidatëve.
- 2) Pjesëmarrja në procesin e trajnimit të parashikuar në Programin e Certifikimit është e detyrueshme për çdo kandidat të regjistruar. Kandidati ka detyrimin të sigurojë pjesëmarrje jo më pak se 70 % të totalit të orëve mësimore për secilin modul për t’u lejuar të hyjë në provimin përkatës.
- 3) Kandidatët që nuk përmbushin pragun minimal të pjesëmarrjes në procesin e trajnimit nuk lejohen të marrin pjesë në provimin me shkrim të atij moduli dhe është i detyruar të rindjekë programin e certifikimit sipas procedurës së përcaktuar në sezonin pasues.
- 4) Struktura përgjegjëse harton listën përfundimtare të kandidatëve që plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes dhe që lejohen të hyjnë në provim për çdo modul dhe e paraqet për miratim te Komisioni. Lista Përfundimtare e miratuar publikohet jo më vonë se 1(një) ditë pune para zhvillimit të provimit.
- 5) Kandidatët që mungojnë për arsye objektive të provuara me dokumentacion zyrtar, pasi të vlerësohen nga struktura përgjegjëse, kanë të drejtë të paraqiten në riprovim për modulin përkatës, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë rregullore.
- 6) Provimi me shkrim për secilin modul dhe riprovimi zhvillohen në përputhje me kalendarin e miratuar nga Komisioni i Kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik në fillim të procesit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

Neni 16

Procedura e hartimit të tezës së provimit

- 1) Komisioni harton dhe miraton tezën/tezat e provimit me shkrim për secilin modul, bazuar në fondin e pyetjeve të dorëzuara nga trajnerët e kategorisë së dytë, jo më vonë se 1 (një) ditë pune para datës së zhvillimit të provimit sipas detyrimeve të parashikuara në këtë rregullore.
- 2) Komisioni për çdo modul, përcakton dhe miraton kriteret dhe metodologjinë për përgatitjen e fondit të pyetjeve, në përputhje me programin e miratuar të certifikimit, që duhet të dorëzohen nga trajnerët e kategorisë së dytë.
- 3) Komisioni harton tezën/tezat e provimit me shkrim për secilin Modul në përputhje me strukturën dhe kriteret e miratuara, si më poshtë vijon;

Përmbajtja e tezës	Përqindja ndaj totalit	Numri i pyetjeve/ushtrimeve/rasteve	Totali i pikëve
Pyetje me alternativa	15%	15 pyetje	15 pikë
Pyetje me shtjellim	25%	5 pyetje	25 pikë
Ushtrime	30%	5 ushtrime	30 pikë
Raste studimore	30%	3 raste	30 pikë
Totali	100%		100 pikë

- 4) Çelësi i zgjidhjes së tezës/tezave publikohet në faqen zyrtare brenda 2 (dy) ditëve pune pas përfundimit të provimit dhe riprovimit.
- 5) Të gjitha proceset që lidhen me përgatitjen, miratimin, shumëfishimin, administrimin dhe ruajtjen e tezës/tezave realizohen vetëm në ambientet e ministrisë përgjegjëse për financat, në përputhje me rregullat e sekretimit dhe sigurisë së dokumentacionit zyrtar të provimeve.

Neni 17

Rregulla të përgjithshme për provimet dhe riprovimet

- 1) Provimi me shkrim për çdo modul dhe riprovimi zhvillohen në ambiente të posaçme të caktuara nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, në përputhje me kalendarin e miratuar nga Komisioni.
- 2) Procesi i provimit me shkrim dhe riprovimit zhvillohet duke respektuar parimet e barazisë, paanësisë, konfidencialitetit dhe anonimitetit të kandidatëve.
- 3) Në provim lejohen të marrin pjesë vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes sipas nenit 15 të kësaj Rregulloreje.
- 4) Provimi me shkrim konsiderohet i kaluar nëse kandidati merr jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) pikë nga 100 (njëqind) pikë.
- 5) Kandidatët që nuk e kalojnë provimin me shkrim në një nga modulet e certifikimit, kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm në një riprovim.
- 6) Riprovimi zhvillohet sipas të njëjtave rregulla dhe procedura si provimi fillestar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

- 7) Ankimi i rezultateve të provimit kryhet sipas procedurës dhe afateve të afateve të përcaktuara në nenin 21 të kësaj rregulloreje.

Neni 18

Provimi i aftësive komunikuese

- 1) Përveç provimeve me shkrim të moduleve, kandidatët i nënshtrohen edhe provimit të aftësive komunikuese, si pjesë përbërëse e detyrueshme e procesit të certifikimit.
- 2) Provimi i aftësive komunikuese zhvillohet pas përfundimit me sukses të të gjitha provimeve me shkrim të moduleve të Programit të Certifikimit.
- 3) Provimi i aftësive komunikuese zhvillohet me gojë, bazuar në fondin e pyetjeve të dorëzuara nga trajnerët e kategorisë së dytë jo më vonë se 1 (një) ditë pune përpara datës së zhvillimit të provimit.
- 4) Provimi i aftësive komunikuese ka si qëllim vlerësimin e:
 - a) aftësisë për të prezantuar gjetjet audituese;
 - b) aftësisë për komunikim profesional me palën e audituar;
 - c) aftësisë për argumentim, etikë dhe qartësi në raportim;
 - d) sjelljes profesionale dhe integritetit.
- 5) Provimi zhvillohet përpara një komisioni vlerësimi i përbërë nga:
 - a) Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm dhe
 - b) Një trajner i kategorisë së dytë i miratuar nga Komisioni.
- 6) Komisioni i vlerësimit përcakton dhe miraton metodologjinë e zhvillimit të provimit.
- 7) Provimi vlerësohet me rezultatin “Kalon” ose “Nuk kalon”. Kalimi i provimit të aftësive komunikuese është kusht i detyrueshëm për pajisjen me certifikatën “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”.
- 8) Rezultati i provimit të aftësive komunikuese nuk i nënshtrohet procedurës së ankimit.

Neni 19

Procedura e administrimit të provimit me shkrim

- 1) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm është përgjegjëse për organizimin dhe administrimin logjistik të provimit me shkrim për çdo modul, provimit me gojë të aftësive komunikuese dhe riprovimit. Këto masa përfshijnë sigurinë logjistike, koordinimin me institucionet mbështetëse, si dhe përgatitjen e materialeve të nevojshme të provimit.
- 2) Tezat e provimit, përpara shpërndarjes, miratohet nga Kryetari i Komisionit, nënshkruhet fletë më fletë nga secili anëtar i Komisionit dhe vuloset pranë zyrës së Protokollit të ministrisë përgjegjëse për financat. Çdo tezë e pavulosur dhe e panënshkruar konsiderohet e pavlefshme.
- 3) Bazuar në numrin e kandidatëve të konfirmuar 1(një) ditë përpara datës së caktuar të provimit me shkrim për çdo modul, përgatitet shumëfishimi i tezës së provimit që do të përdoren nga kandidatët.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

- 4) Kandidati plotëson të dhënat identifikuese në seksionin e identifikimit të veçantë, i cili shkëputet dhe administrohet nga Komisioni përpara fillimit të procesit të korrigjimit, me qëllim garantimin e anonimitetit të tezës së provimit.
- 5) Kandidati ka detyrimin të zhvillojë tezën e provimit vetëm me mjetet e shkrimit të lejuara dhe në përputhje me udhëzimet e Komisionit. Çdo shkrim jashtë hapësirave të parashikuara ose shenjë që mund të identifikojë kandidatin në mënyrë të parregullt përbën shkelje të rregullave të provimit dhe kusht për skualifikimin e tij nga provimi.
- 6) Tezat e vulosura dhe të nënshkruara iu shpërndahen kandidatëve përpara fillimit të provimit. Mbikëqyrësit e provimit verifikojnë identitetin e secilit kandidat duke plotësuar listëprezencën me nënshkrimin e kandidatëve pjesëmarrës në provim. Kandidatët në përfundim të provimit, dorëzojnë tezën e provimit të zhvilluar, si dhe materialet e tjera të provimit tek mbikëqyrësi përkatës në sallën e provimit.
- 7) Kandidatët janë të detyruar që gjatë zhvillimit të provimit të respektojnë rregullat e vendosura. Çdo tentativë për kopjim, komunikim të paautorizuar, ose përdorim të pajisjeve elektronike ndalohet rreptësisht, si rrjedhim sjell përjashtimin e menjëhershëm nga provimi.
- 8) Në ambientet ku zhvillohen provimet dhe riprovimi nuk lejohet prania e personave të paautorizuar. Prania është e kufizuar vetëm për:
 - a) Kryetarin dhe anëtarët e Komisionit;
 - b) Mbikëqyrësit e caktuar të sallës;
 - c) Përfaqësuesit e strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm përgjegjës për administrimin e procesit të provimit;
- 9) Në përfundim të provimit mbikëqyrësit i dorëzojnë listëprezencën dhe tezat e provimit të zhvilluara me proces verbal të nënshkruar Komisionit. Çdo mospërputhje në numrin e tezave të provimit dhe numrit të kandidatëve që kanë marrë pjesë në provim, regjistrohet në procesverbal dhe raportohet menjëherë tek autoriteti përgjegjës.

Neni 20
Mbikëqyrësi i provimit

- 1) Mbikëqyrësit e sallave të provimeve, të cilët veprojnë si persona administrativë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të provimit zgjidhen nga Nëpunësi i parë autorizues me propozim të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm. Numri i mbikëqyrësve për çdo sallë është të paktën 1(një) person për çdo 20 (njëzetë) kandidatë;
- 2) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm harton dhe administron zbatimin e kontratave individuale të mbikëqyrësve lidhur me Drejtorin të Përgjithshëm, në të cilat përcaktohen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë administrative të mbikëqyrësve;
- 3) Mbikëqyrësit, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, kanë për detyrë:
 - a) të verifikojnë identitetin e kandidatëve në sallë;
 - b) të shpërndajnë dhe të mbledhin materialet e provimit në mënyrë të kontrolluar;
 - c) të parandalojnë çdo parregullsi, shkelje ose tentativë për mashtrim;
 - d) të sigurojnë mbarëvajtjen e procesit;
 - dh) të hartojnë dhe dorëzojnë raport me shkrim për çdo rast të dyshuar për shkelje

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

- e) të mos komunikojnë me kandidatët mbi përmbajtjen e pyetjeve ose përgjigjeve;
- ë) detyra të tjera të ngarkuara nga Komisionin dhe/ose Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 21

Procedura e korrigjimit të provimit dhe e shpalljes së rezultateve para prake

- 1) Komisioni zhvillon procedurat e sekretimit të tezave dhe i dorëzon me proces verbal te korrigjuesit. Përpara fillimit të procesit të korrigjimit, Komisioni siguron anonimizimin e çdo teze, duke mbuluar të dhënat identifikuese të kandidatit. Çdo shkelje e procesit të anonimizimit konsiderohet cënim i integritetit të provimit dhe sjell përsëritjen e procedurës së korrigjimit.
- 2) Korrigjimi i tezave zhvillohet në ambientet e ministrisë përgjegjëse për financat dhe i gjithë procesi monitorohet dhe administrohet nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm duke u siguruar trajnerëve që korrigjojnë ambiente të përshtatshme për korrigjim.
- 3) Korrigjimi i provimeve me shkrim kryhet nga trajnerët korrigjues të caktuar nga Komisioni posaçërisht për këtë qëllim. Korrigjimi bëhet në përputhje me udhëzimet zyrtare të miratuara për provimin dhe sipas skemës përkatëse të vlerësimit.
- 4) Trajneri/ët korrigjues, përfundon korrigjimin brenda 5(pesë) ditëve kalendrike dhe përgatit listën e rezultateve të nënshkruar në çdo fletë në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm. Për çdo mungesë fletësh mbahen procesverbale duke argumentuar dhe provuar mungesën e testit të provimit.
- 5) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, përgatit listën me rezultatet paraprake të kandidave dhe e paraqet për miratim tek Komisioni bashkë me tezat e provimeve të korrigjuara.
- 6) Komisioni cakton datën e ç'sekretimit dhe harton listën paraprake me rezultatet paraprake.
- 7) Pas miratimit nga Komisioni, struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm publikon në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat rezultatet paraprake të provimit me shkrim për çdo modul duke siguruar anonimin, bazuar në numrin personal të identifikimit.
- 8) Rezultatet paraprake i nënshtrohen procedurës së ankimit sipas nenit 21 të kësaj rregulloreje.
- 9) Komisioni cakton trajnerë të tjerë për rikorrigjim, të cilët brenda 2(dy) ditëve pune nxjerrin rezultatet e rishikimit të provimit dhe ja përcjellin Komisionit.

Neni 22

Procedura e vlerësimit përfundimtar të provimeve

- 1) Pas përfundimit të procedurës së ankimit dhe rikorrigjimit, Komisioni miraton rezultatet përfundimtare të provimit.
- 2) Rezultatet përfundimtare të provimit publikohen në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat, brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditësh nga përfundimi i procesit të korrigjimit.
- 3) Vendimi i Komisionit për rezultatet përfundimtare është i formës së prerë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

Neni 23

Procedura e ankimit të rezultatit të provimit

- 1) Çdo kandidat ka të drejtë të ankimojë rezultatin e provimit me shkrim për çdo modul brenda një afati prej 2 (dy) ditësh pune nga dita e publikimit të rezultateve.
- 2) Kandidatët paraqesin ankesën me shkrim pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm dhe duhet të përmbajë:
 - i. të dhënat identifikuese të kandidatit;
 - ii. arsyetimin e ankesës;
 - iii. dokumentet shoqëruese, nëse ka;
 - iv. kërkesën specifike që paraqet kandidati.
- 3) Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e ankesës, Komisioni cakton trajnerë për rikorrigjimin e provimit, të cilët brenda 2(dy) ditëve duhet të paraqesin rezultatin e rikorrigjimit
- 4) Vendimi i Komisionit për ankimin i komunikohet me shkrim kandidatit dhe është i formës së prerë pra nuk mund të ankimohet më tej.
- 5) Komisioni garanton transparencën dhe paanshmërinë në shqyrtimin e çdo ankese dhe siguron ruajtjen e integritetit të procesit të vlerësimit.

Neni 24

Procedura e njohjes të Certifikatës Profesionale Ndërkombëtare

- 1) Njohja zyrtare e certifikatës profesionale në fushën e auditimit të brendshëm, bazohet në parimin e ngjashmërisë së programeve/moduleve profesionale të trajnimit të kryer nga aplikantët jashtë vendit në masën 75%, me programin/modulet e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, të miratuar nga Komisioni.
- 2) Baza e vlerësimit të programeve dhe kurseve profesionale të kryera jashtë vendit në fushën e auditimit të brendshëm, janë programet/modulet e trajnimit, koha e studimit, si dhe kualifikimet që përcaktohen nga kuadri ligjor i vendit të origjinës, krahasuar me kuadrin ligjor dhe nënligjor shqiptar.
- 3) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore në fuqi, në bashkëpunim me Komisionin, ndjek procedurat e njohjes së certifikatave profesionale ndërkombëtare në fushën e auditimit të brendshëm të individëve që i zotërojnë ato, sipas kritereve të më poshtme:
 - a) Individët që zotërojnë një certifikatë profesionale të njohur ndërkombëtarisht në fushën e auditimit të brendshëm, dorëzojnë dosjen e aplikimit për njohje pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.
 - b) Dosja e aplikantit duhet të përmbajë këto elementë:
 - i. Kërkesë me shkrim për aplikim;
 - ii. Certifikatën e kualifikimit profesional të marrë jashtë vendit;
 - iii. Programet/modulet e mbrojtura dhe kreditet e marra;
 - iv. Dokument identifikimi.
 - v. Vërtetim nga institucioni/organizata që lëshon certifikatën, që specifikon numrin serial unik të individit, datën e marrjes së certifikatës dhe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

vlerësimin respektiv, apo linkun në faqen zyrtare të institucionit që ka lëshuar certifikatën i cili mundëson verifikimin e procesit të certifikimit të kryer..

- 4) Dokumentat e përcaktuara në pikën ii) dhe iii), të germës b) të këtij neni, duhet të jenë origjinale ose fotokopje e përkthyer dhe e noterizuar.
- 5) Komisioni, pasi shqyrton dosjen merr vendim për njohjen e certifikatës profesionale ndërkombëtare ose mund të vendosë t'ia kthejë dosjen aplikantit për plotësime të nevojshme, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga vënia në dispozicion e dosjes së aplikimit.
- 6) Në rastet e mos njohjes së certifikatës profesionale ndërkombëtare, të fituar nga aplikanti jashtë vendit, për arsyet e mosplotësimit të një nga kushteve të mësipërme, Kryetari i Komisionit, njofton me shkrim aplikantin brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e marrjes së vendimit të Komisionit, për mosnjohjen e certifikatës me arsyetimin përkatës.
- 7) Aplikanti ka të drejtë të bëjë ankimim me shkrim tek struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e njoftimit. Vlerësimi i ankimit nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm i përcillet Komisionit, i cili merr një vendim përfundimtar.
- 8) Aplikanti të cilit i njihet certifikata profesionale ndërkombëtare e fituar jashtë vendit, pajiset nga Komisioni me vërtetim, si një dokument i barazvlefshëm për certifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.

Neni 25

Certifikata “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”

- 1) Në përfundim të procesit të certifikimit, kandidatët fitues duhet të pajisen me certifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.
- 2) Ky dokument lëshohet sipas modelit të miratuar nga ministri përgjegjës për financat dhe përmban elementët e mëposhtëm:
 - a) Emrin, atësinë dhe mbiemrin e kandidatit fitues;
 - b) Numrin rendor i cili regjistrohet progresivisht në “Regjistrin Kombëtar të Audituesve të Brendshëm”;
 - c) Bazën ligjore në fuqi për lëshimin e certifikatës;
 - d) Titullin profesional të fituar “Auditues i Brendshëm në sektorin publik”.
- 3) Certifikata duhet të lëshohet në afatin kohor deri në 3 (tre) muaj pas përfundimit të procesit të certifikimit. Deri në pajisjen me certifikatë, individëve u lëshohet nga ministria përgjegjëse për financat një vërtetim, i cili shoqërohet me fletën e programit sipas moduleve të përfunduara.
- 4) Tërheqja e certifikatës do të bëhet nga vetë kandidati fitues, kundrejt nënshkrimit dhe evidentimit në regjistrin përkatës. Nëse prania fizike e kandidatit fitues është objektivist e pamundur, tërheqja e certifikatës mund të bëhet edhe nga persona të autorizuar, përkundrejt një prokure të posaçme e shoqëruar me dokument identifikimi.

Neni 26

Ruajtja dhe asgjësimi i dokumentacionit lidhur me certifikimin

- 1) Dokumentet zyrtare që përgatiten lidhur me procesin e certifikimit dorëzohen dhe ruhen në

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM
KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM

fund të çdo sezoni në arkivën e ministrisë përgjegjëse për financat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të tezave të provimeve dhe riprovimeve të kandidatëve pjesëmarrës të procesit të certifikimit, të cilat ruhen deri në 6 (gjashtë) muaj nga data e dhënies së provimit ose/dhe riprovimit.

2) Asgjësimi i tyre bëhet nga një komision prej 3 (tre) anëtarësh, të caktuar nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, në përbërje të të cilit janë dy punonjës të strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm dhe një punonjës i strukturës përgjegjëse për shërbimet në ministrinë përgjegjëse për financat. Deri në asgjësimin e tyre, tezat e provimit administrohen nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.

Neni 27

Mënyrat e informimit dhe komunikimit

1) Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, publikon në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat të gjitha informacionet në lidhje me njoftimin për aplikim, shpalljen e kandidatëve fitues, modulet e programit, leksionet, shembuj të rasteve praktikë, literaturën bazë dhe të rekomanduar, datat dhe rezultatet e testeve paraprake, provimeve me shkrim dhe me gojë, riprovimeve, listën përfundimtare me kandidatët fitues, si dhe çdo informacion tjetër që lidhet me procesin e certifikimit.

2) Mënyra e komunikimit midis strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm Komisionit, trajnerëve, mbikëqyrësve dhe kandidatëve për auditues të brendshëm, duhet të jetë sa më transparente duke përdorur të gjitha mjetet, përfshirë ato elektronike dhe shkresore.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga ministri përgjegjës për financat dhe publikimit sipas legjislacionit në fuqi.